

Në përputhje me prioritetin e MSHMS për digjitalizimin e informacionit shëndetësor, FSDKSH në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit ka zhvilluar dhe implementuar disa sisteme.

Keto sisteme, në qendër të cilave është individ dhe dosja e tij elektronike shëndetësore, shërbejnë gjithashtu për të rritur transparencën në komunikimin me publikun për gjendjen e shëndetit të popullatës, duke përdorur burimet e disponueshme.

Më poshtë po listojmë këto sisteme:

- e-Prescription për shërbimin shëndetësor eRx (Sistemi Informatik i regjistrimit të recetave elektronike në Republikën e Shqipërisë).
- Regjistri elektronik për formularët e vizitave të mjekut të familjes (eVizita)
- Zhvillimi Software moduli i Depove Farmaceutike (eDepo)
- eKontroll, Sistemi i kontrollit të subjekteve që kanë kontratë me FSDKSH

Të gjitha këto sisteme, falë edhe ndërveprimit me sisteme të tjera qeveritare, si: Regjistrin e barnave nga AKBPM, Sistemit të Gjendjes Civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve etj, kanë mundur një standardizim, uniformitet dhe përqëndrim të informacionit që ruhet dhe përpunohet nga ato. Gjithashtu, këto ndërveprime sigurojnë saktësi më të lartë të të dhënave që ruhen në këto sisteme.

Përdorimi i këtyre sistemeve ka mundur reduktimin e punës manuale dhe përdorimit të letrës, duke reduktuar ndjeshëm gabimet njerëzore. Këto sisteme ofrojnë mundësi të përpunimit në kohë reale të informacionit me qëllim vendimarrje më të mirë duke iu referuar raporteve dhe indikatorëve.

Përdorimi i këtyre sistemeve të teknologjive dhe pajisjeve bashkëkohore si dhe vendosja e tyre në ambiente me kushte teknike sipas standarteve të miratuara, siguron cilësinë e shërbimit dhe disponueshmëri të lartë të tyre.

Konkretisht:

A. Sistemi informatik i regjistrimit të recetave elektronike në Shqipëri ka këto avantazhe:

- Rritje e saktësisë në përshkrimin e barnave në recetë duke implementuar në sistem rregullat dhe kufizimet përkatëse
- Reduktimin në maksimum të gabimeve njerëzore në përpilimin e recetes
- Pikasje dhe shmangie të mashtrimeve të recetave (recetave fiktive)
- Reduktim të kostove që kanë të bëjnë me eliminim të recetes në formën leter.
- Reduktim i punës voluminoze manuale për përlogatitjen e rimbursimit të farmacive për barnat e rimbursueshme
- Ruajtja e dosjes elektronike të recetave të rimbursueshme të çdo pacienti
- Siguri e lartë aksesimi në sistem me përdorimin e user-it personal për mjekët, farmacistët etj si dhe të firmes digjitale. etj

Një tjetër risi që ka të bëjë me përmirësimin në sistemin e recetës elektronike eRx është se në kuadër të punës për përballimin të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, tashmë çdo shtetas

shqiptar mund te aplikoje per recete per Covid-19 nepermjet llogarise personale ne portalin eAlbania.

Prej nentorit te vitit 2021, ka iniciuar implementimi i nenshkrimit elektronik nepermjet teknologjise RSS ne kete sistem, duke thjeshtuar procedurat per pajisje me nenshkrim per profesionistet e shendetesise.

B. Regjistri elektronik për formularët e vizitave të mjekut të familjes (eVizita)

Perfitime direkte:

- Reduktim i kohes se stafit mjekesor te QSH per plotesimin e formularit leter
- Reduktim te gabimeve pergjate plotesimit dhe hedhjes ne sistem te formulareve.
- Reduktim i kostove te formularit leter

Me implementimin e ketij sistemi jane mundesuar:

1. Ndertimi i portalit te mjekut te familjes dhe modulit "Single Sign On" që bën të mundur aksesimin me nje llogari te sistemeve:
 - Sistemi i Regjistrimit Elektronik i te siguruarve (AHIS)
 - Sistemi i Formularit te Vizites (SISHP)
 - Sistemi i Referimit Online (e-Referimi)
 - Sistemi i Recetes elektronike (e-Rx)
 2. Regjistrimi online i formularit te vizites dhe nderveprimi me sistemet e tjera elektronike gjë e cila rrit saktesine e te dhenave
 3. Krijimi i regjistrimit elektronik online të te dhenave shendetesore te pacientit prane mjekut te familjes.
 4. Realizim i workflow të informacionit midis sistemeve te mjekut te familjes:
 - Autentifikim ne portalin e mjekut
 - Fillimi i plotesimit te formularit te vizites (te dhenat e pacientit merren nga AHIS)
 - Plotesim recete (te dhenat merren nga e-vizita)
 - Plotesim referimi (te dhenat merren nga e-vizita)
 5. Pasurim i formularit aktual të vizitës me shenjat jetesore per pacientet
 6. Historik shëndetësor i të dhënave të pacientit pranë mjekut të familjes. Akses nga mjeku i familjes dhe nga vetë pacienti
- Raporte ne kohe reale te qenderzuara per QSH dhe FSDKSH mbi te dhenat nga sistemet e mjekut te familjes për vendim-marrje klinike, manaxheriale dhe administrative.

C. Zhvillimi Software moduli i Depove Farmaceutike (eDepo)

- Mundëson një pasqyrë të konsoliduar te informacionit mbi inventarin e depove farmaceutike per barnat e rimbursueshme duke trajtuar gjendjen e inventarit, fletë - hyrjet nga grosistet si edhe flete - daljet drejt depove te tjera distributore apo subjekteve farmaceutike.

- Nderveprim me sistemin e regjistrimit dhe kontrollit të barnave (AKBPM) për të dhënat e barnave me rimbursim dhe subjekteve farmaceutike duke mundësuar një kontroll me cikël të mbyllur, AKPBM-DEPO-RRJET FARMACEUTIK.
- Nderveprim me sistemin elektronik të DPT-së për regjistrimin e subjekteve farmaceutike.
- Reduktimin e punës manuale me përpunimin e të dhënave dhe të nxjerrjes së statistikave dhe raportimeve të ndryshme mbi sasine dhe vlerën e barnave të rimbursueshme që tregtohen nga depot farmaceutike
- Ruajtje dhe aksesim nga ana e Fondit të informacionit historik mbi hyrje-daljet e importuesve dhe distributoreve farmaceutike

D. eKontroll, Sistemi i kontrollit të subjekteve që kanë kontratë me FSDKSH

- Menaxhim elektronik i gjithë procesit të lidhjes së kontratave të subjekteve (Farmaci/Agjenci Farmaceutike/ Depo Farmaceutike/QSH/Spitale) me FSDKSH, duke filluar që nga aplikimi nepermjet eAlbania deri në lidhjen e kontratës.
- Menaxhim elektronik hap pas hapi të proceseve të kontroleve të FSDKSH për përbushjen e detyrimeve kontraktuale.
- Komunikim elektronik i FSDKSH me subjektet, lidhur me kontratat dhe me kontrollet e kryera duke evituar kontaktet dhe levizjet e panevojshme të paleve
- Ruajtje dhe aksesim i informacionit dhe dokumentacionit historik mbi kontratat e lidhura dhe kontrollet e kryera mbi subjektet.

E. Regjistri Elektronik i të Siguruarve (AHIS)

Mundëson regjistrimin e banorëve pranë mjekut të familjes në Qendrat Shëndetësore të Sistemit Shëndetësor Parësor, si edhe përcaktimin e kategorisë së përfitimit të pacientit bazuar në ndërveprimin me institucionet e tjera si ISSH, DPT, DPGJC.

Risitë e fundit në sistemin e Regjistrimit Elektronik të të Siguruarve (dhe Kartës së Shëndetit) (AHIS):

Ndërveprimi i AHIS me Portalin Qeveritar eAlbania mundëson që:

1. Çdo shtetas shqiptar të gjenerojë kartën e tij të shëndetit nepermjet llogarise personale në portalin eAlbania
2. cdo shtetas shqiptar mund të aplikojë nepermjet eAlbania për:
 - a. regjistrimin tek mjeku i familjes
 - b. ndryshimin e mjekut të familjes

Tashme, Regjistri Elektronik i të Siguruarve është i integruar me sistemin e ri të regjistrimit të Vizitave të pacientëve pranë mjekut në Sistemin Shëndetësor Parësor (eVizita). Sistemi eVizita mundëson jo vetëm regjistrimin e vizitave, por njëkohësisht shërben si Portal i Mjekut; ku nga mjeku i familjes mund të aksesohen:

- Sistemi i Regjistrimit Elektronik të të Siguruarve (AHIS)
- Sistemi i Formularit të Vizitës (SISHP)
- Sistemi i Referimit Online (e-Referimi)
- Sistemi i Recetës Elektronike (e-Rx)

Ndërveprimi i sistemit e Vizita me Portalin Qeveritar eAlbania mundëson që:

1. Çdo shtetas shqiptar te shohe vizitat e tij nepermjet llogarise se vet ne portalin eAlbania
2. Çdo shtetas shqiptar i vaksinuar me vaksinen anti Covid-19 mund te marre vertetimin per vaksinimin per Covid-19 nepermjet llogarise se vet ne portalin eAlbania
3. Çdo shtetas shqiptar mund te aplikojë për t'u vaksinuar kundër Covid-19 nepermjet llogarise personale ne portalin eAlbania. Aplikimi i shfaqet mjekut perkates te familjes ne llogarine e tij Gjatë vitit 2020 sistemi e-Vizita mori disa zhvillime te reja veçanërisht ne lidhje me suportimin e përballimit të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 siç ishte dhe vendosja në dispozicion të mjekëve të formularit të vizitës Covid -19.

Fondi ofron një sërë shërbimesh elektronike në platformën eAlbania, per qytetarin dhe per subjektet farmaceutike qe kerkojne te lidhin kontrate me Fondin.

- Aplikim për kartë shëndeti
- Aplikim për kartë shëndeti për fëmijën nga kryefamiljari
- Aplikim për ndryshimin e mjekut të familjes
- Gjenerimi i kartës së shëndetit për fëmijët nga kryefamiljari
- Gjenerim i kartës së shëndetit
- Lista e sëmundjeve kronike
- Lista e çmimeve të barnave të rimbursueshme
- Regjistrim i individit pranë mjekut të familjes
- Receta ime
- Aplikim per rilidhjen e kontrates vjetore me depot farmaceutike
- Aplikim për lidhje kontrate me importuesit/ shpërndarësit farmaceutik/ importuesit e fishave të diabetit
- Aplikim për lidhjen e kontratës për herë të parë me agjencitë dhe farmacitë e tregut të hapur
- Aplikim për rilidhjen e kontratës vjetore me agjencitë dhe farmacitë e tregut të hapur